

Në muajin maj të vitit 1998, e tërë familja e Haxhiut e ka braktisur fshatin dhe ka kaluar në fshatin Tushilë/Tušilje [Skënderaj/Srbica]. Haxhiu ka mbetur vetëm në shtëpi. Në datën **13.07.1998**, banori i fshatit Mehmet Hoti e ka njoftuar familjen e Haxhiut se gjatë sulmit të forcave serbe kundër **Reznikut/Resnik**, një predhë ka eksploduar pranë shtëpisë së Haxhiut duke e lënë atë të vdekur në vend. Dy ditë më vonë, djali i Haxhiut, Ukshini, me ndihmën e bashkëfshatarëve, e ka varrosur Haxhiun në varrezat lokale, ku ai prehet edhe sot.

**Burimi:** deklarata S.H, FDH-20209.

### Saša (Ratimir) Filipović

(10.02.1974, serb nga Beogradi, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Saša filloi nga puna në Sekretariatën e Punëve të Brendshme të Rakovicës [Beograd] nga muaji shtator i vitit 1992. Për të parën herë, e kanë dërguar në Kosovë në fillim të vitit 1998. Në muajin korrik të vitit 1998, ka shkuar sërish në Kosovë. Ishte i stacionuar në fshatin Grabc/Grabac. Në mbrëmjen e datës **17.07.1998**, familjes së tij i ishte kumtuar se Saša e kishte humbur jetën në luftimet me pjesëtarë të UÇK-së në fshatin **Grabc/Grabac**. E kanë varrosur në varrezat e qytetit të lindjes në Mojkovc [Mali i Zi], më 19.07.1998.

**Burimet:** deklarata M.F, FDH-20484; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 73; SMIP, *Teroristički...*, III, 935; M. Sekulić, *Beograd...*, 95.

### Xhemajl (Hysen) Dakaj

(1924, shqiptar nga fshati Cerrovikë/Cerovik, komuna e Klinës/Klina, bujk, tetë fëmijë)

Xhemajli i moshuar jetonte në bashkësi familjare me djemtë e vet dhe familjet e tyre. E tërë familja i numëronte 16 anëtarë. Që të gjithë se bashku e braktisën shtëpinë në fund të muajit maj të vitit 1998, kur forcat serbe e sulmuan fshatin. U strehuan në pyll që i takonte fshatit fqinj të Murgës/Murga [komuna e Skënderajt/Srbica]. Në datën **18.07.1998**, Xhemajli, së bashku me disa bashkëfshatarë, u nis me traktor për në **Cerrovikë/Cerovik**, ku planifikonin të merrnin miell. Situata në fshat ishte e

qetë, por kur kalonin pranë ambulancës, forcat serbe e hedhën një granatë nga pozicionet e tyre. Predha e qëlloi Xhemajlin, duke e lënë të vdekur në vend. E varrosën pas mesnate, më 19.07.1998, në varrezat e fshatit Murgë/Murga. Në muajin shtator të vitit 1999, trupi i tij u rivarros në varrezat e Cerrovikut/Cerovik.

**Burimi:** deklarata M.D, FDH-19324.

### Luan (Sefer) Gashi

(18.11.1979, shqiptar nga Sverka/Svrhe, komuna e Klinës/Klina, nxënës)

Luan i ka qenë nxënës i klasës së dytë të shkollës së mesme. Jetonte me prindërit, motrat dhe vëllezërit e vet. Në pasditen e datës **19.07.1998**, Luan i ka shkuar për ta vizituar axhën Zenel [Sverkë/Svrhe]. Ishin të ulur në oborr kur, diku nga ora 17:30, forcat serbe nisën me bombardimin e fshatit. Njëra prej predhave ra në oborr vetëm pesë metra larg Luanit dhe farefisit të tij. Eksplodimi i saj e ka plagosur rëndë Luanin, duke e qëlluar në kokë dhe në gjoks. Nëna Mereme dhe dhëndri Sokoli e kanë kthyer Luanin e plagosur në shtëpi. Pas pak, ai dha shpirt në duart e nënës. Ditën e nesërme, familjarët e kanë varrosur Luanin në varrezat e fshatit. Në datën 12.03.2000, patologët ndërkombëtar i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të Luanit për të kryer obduksionin e tyre. Më 14.03.2000, ato sërish u varrosën në varrezat lokale.

**Burimi:** deklarata B.G, FDH-17158.

### Radoš (Petar) Krstić

(18.04.1954, serb nga Zajmova/Zajmovo, komuna e Klinës/Klina, nëpunës)

Radoši punonte në Gjykatën Komunale të Klinës/Klina. Në mëngjesin e datës **20.07.1998**, rreth orës 7:00, Radoši e ngjiste biçikletën në rrugën Prishtinë/Priştina – Pejë/Peć. Kur arriti te fshati **Zajmovë/Zajmovo**, afër urës mbi lumin Drin/Drim dhe hotelit *Nora*, atë e qëlluan nga pushkë snajperi. Ka dhënë shpirt në vend. Një ditë më vonë, trupi e tij të pajetë e ka gjetur policia serbe.

**Burimet:** USCG KGDH, *Registri...*, FDH-